




Financuar nga Bashkimi  
Europian

Bashkëfinancuar nga  
Bashkëpunimi Suedez  
për Zhvillim



Sweden  
Sverige



# Statistika gjinore dhe përfshirja e perspektivës gjinore në sistemin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Konkluzione dhe rekomandime

Skupi, 2022



Financuar nga Bashkimi  
Europian

Bashkëfinancuar nga  
Bashkëpunimi Suedez  
për Zhvillim



Sweden  
Sverige

# Statistika gjinore dhe përfshirja e perspektivës gjinore në sistemin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut

## Konkluzione dhe rekomandime

Skupi, 2022

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe me bashkëfinancim nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Reactor-Research in Action dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose Sida.

Mostër falas/jokomerciale

Zbatuar nga:

REACTOR  
research in action



KVINNA  
KVINNA



PRAVA  
ZASV=

WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA

# Contents

Çfarë është statistika gjinore?.....	4
Shkurtimisht për sistemin statistikor dhe përmbledhjet e statistikave gjinore ..	5
Rekomandime .....	8
Përfshirja e perspektivës gjinore në sistemin statistikor .....	8
Treguesit gjinorë që janë në dispozicion .....	9
Të dhënat administrative të disponueshme nga institucionet kombëtare që mund të përdoren për të informuar politikën për barazi gjinore.....	11
Barazia gjinore - një vështrim i shkurtër përmes numrave.....	11
Shpërndarja e barabartë e fuqisë dhe ndikimit.....	12
Barazia financiare midis grave dhe burrave.....	13
Ndarja e barabartë e kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake.....	16
Arsimi i barabartë.....	17
Shëndeti i barabartë .....	19
Dhuna me bazë gjinore duhet të ndalet.....	20

## Çfarë është statistika gjinore?

Statistika gjinore duhet të pasqyrojë realitetin në të cilin jetojnë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, me të gjitha dallimet e tyre, dhe të na lejojnë të "shohim" pabarazitë gjinore në shoqëritë tona dhe ndryshimet me kalimin e kohës, nëse ato ndodhin. Prandaj, statistika gjinore është thelbësore për planifikimin e politikave publike për barazi gjinore dhe për vlerësimin e efekteve të përpjekjeve të tilla.



# Shkurtimisht për sistemin statistikor dhe përmbledhjet e statistikave gjinore

**Ligji për Statistikën Shtetërore**<sup>1</sup> (LSSh) rregullon organizimin dhe fushën e punës së statistikës shtetërore në përgjithësi, bazat metodologjike dhe organizative të kërkimeve statistikore, mbledhjen, përpunimin, prezantimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore.<sup>2</sup>

**Enti Shtetëror për Statistikë (EShS)** kryen detyrat dhe aktivitetet kryesore në lidhje me statistikën shtetërore në Maqedoninë e Veriut përmes kryerjes së kërkimeve statistikore dhe duke marrë të dhëna nga mbledhësit e të dhënave.<sup>3</sup> Kërkimet statistikore kryhen edhe nga **bartës të tjerë të veprimtarisë statistikore: Banka Kombëtare, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Punësimit, Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Hidrometeorologjik dhe Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor.**

Njëra nga anët e forta të sistemit nacional statistikor është se **legjislacioni statistikor, dhe kryesisht Ligji për Statistikë, është bashkëkohor, gjithëpërfshirës dhe në pjesën më të madhe në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane.**<sup>4</sup>

Sidoqoftë, duke analizuar **Ligjin për Statistikë Shtetërore** nga këndvështrimi gjinor, duhet të theksohet se në formën e tij të tanishme, ky ligj **nuk përmend, nuk përcakton ose nuk parashikon ndonjë detyrim për institucionet në aspektin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe seksit ose statistikave gjinore.** Për krahasim, në **Suedi që nga mesi i viteve 1990, kërkohet që statistikatat të grupohen sipas gjinisë.**<sup>5</sup> Përkatësisht, **neni 14 i Rregullores për statistikë zyrtare të Suedisë (2001:100) thotë se të dhënat zyrtare statistikore në lidhje me individët duhet të**

---

1 Ligji për Statistikë Shtetërore. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 54/97, 21/07, 51/11, 104/13, 42/14, 192/15, 27/16, 83/18 dhe 220/18.

2 Ibid. neni 1.

3 Ibid. neni 5.

4 Alldritt, R., de Pourbaix, I. & Carlquist, T. (2017). Rishikimi i zbatimit të Kodit të Praktikës së Statistikës Evropiane në Republikën e Maqedonisë dhe roli koordinues i Entit Shtetëror Statistikor, f.10. Gjetet në: <https://bit.ly/3jD4hJH>

5 Intervistë me përfaqësues nga Statistikat e Suedisë e mbajtur më 23.11.2021.

**ndahen sipas gjinisë, përveç nëse ka arsye specifike për të mos e bërë këtë.**<sup>6</sup> Për më tepër, statistika suedeze ka përgatitur gjithashtu udhëzime për të mbështetur këtë zbatim në Seksionin 14.

**Programi për Kërkime Statistike** është një akt nënligjor që përcakton se cilat anketa statistike do të kryhen dhe rendit të gjitha kërkimet që do të prodhonin statistikat zyrtare për një periudhë pesëvjeçare. Programi është përgatitur në përputhje me parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe ka për qëllim të sigurojë të dhëna të krahasueshme mbi zhvillimin e vendit si bazë për një proces të informuar për aderim në BE.

Në Programin ekzistues 2018-2022 janë realizuar gjithsej 319 kërkime statistike nga nëntë bartësit e veprimtarisë statistike. Ajo është organizuar në tre fusha: statistika demografike dhe sociale, statistika ekonomike dhe mjedisore, dhe statistika në më shumë fusha. Në tekstin e Programit, të dhënat e ndara sipas gjinisë përmenden në përshkrimin e shkurtër tek 48 nga 319 kërkimet e parashikuara statistike.

Aktualisht po përgatitet një Program i ri pesëvjeçar për kërkime statistike dhe ky proces është një mundësi për të përfshirë perspektivën gjinore në statistikat zyrtare, sipas nevojave të politikave publike për barazinë gjinore.

Botimi **Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut** është një përmbledhje e statistikave gjinore të përpunuara nga EShS për më shumë se 20 vjet, ndërsa deri më tani ka dymbëdhjetë botime. Publikimi i fundit në dispozicion tregon të dhëna të ndara sipas gjinisë të kategorizuara në tre pjesë tematike: Popullsia dhe shëndeti, Arsimi dhe komunikimi, Tregu i punës dhe Mbrojtja sociale. Deri në vitin 2017, edicioni gjithashtu kishte edhe një pjesë tematike, Drejtësia, ndërsa edicionet 2008 dhe 2010 përmbanin gjithashtu pjesë rreth zgjedhjeve, por asnjë nuk u përfshi në botimin e fundit. Të gjitha të dhënat statistike të paraqitura janë të përbëra nga dhjetë burime të listuara, duke përfshirë edhe Regjistrimin e popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2001) dhe vlerësimet vijuese të bazuara në të dhënat e regjistrimit. Mund të thuhet se do të mund të përdroreshin më shumë kërkime statistike si burim i të dhënave të ndara sipas gjinisë, sepse, siç u përmend më parë, gjinia renditet si një variabël në përshkrimin e shkurtër në vetëm 48 kërkime statistike të Programit Statistikor Pesëvjeçar (2018-2022). Burimet e përmendura përfshijnë Institutin e Shëndetit Publik (për përçindjen e abortit), por asnjë nga organet e tjera të autorizuara për statistikë shtetërore nuk është i përmendur qartë.

6 Statistikat Suedi (2020). Gratë dhe Burrat në Suedi 2020, Fakte dhe Numra, f.5. Gjetet në: <https://bit.ly/3kho0yt>

**Baza e të dhënave MakStat** përmban 28 dosje kryesore të ndara më tej në nën-dosje tematike. Një nga dosjet kryesore është e shënuar si tregues gjinorë (e quajtur më parë si treguesit e seksit) dhe përmban gjithsej 70 përmbledhje të të dhënave. Në dosjet kryesore të tjera (me përjashtim të të dhënave nga regjistrimi i vjetër), 195 përmbledhje të dhënash përmbajnë një variabël të shënuar si "seksi" dhe 150 grupe të dhënash përmbajnë një variabël të shënuar si "gjinia". Pavarësisht nga emërtimi, të dy variablat përmbajnë kategoritë "burra" dhe "gra" ose ndonjë variacion të tyre (p.sh. studentë dhe studente). Grupet e të dhënave të disponueshme ndryshojnë sipas datës së përditësimit të fundit. Në dosjen e quajtur **Treguesit gjinorë në bazën e të dhënave MakStat**, janë në dispozicion gjithsej 70 tregues që mund të klasifikohen në shtatë fusha tematike, përkatësisht popullsia, arsimi, komunikimi TI, tregu i punës, mbrojtja sociale, gjyqësori dhe vendimmarrja. Struktura e fushave tematike i ngjan botimit Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut, por me pasurimin me të dhënat për gjyqësorin dhe vendimmarrjen, fushat tematike, të cilat në të vërtetë kanë qenë të pranishme në versionet e mëparshme të broshurës, por jo edhe në botimet e fundit. Baza e të dhënave u ofron përdoruesve një pasqyrë të përqendruar të statistikave gjinore që janë në dispozicion.

Sipas Ligjit për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik<sup>7</sup> organet dhe institucionet e sektorit publik janë të detyruar të publikojnë të dhënat që mbledhin gjatë kryerjes së kompetencave të tyre (neni 5) dhe sipas ligjit, këto të dhëna duhet të jenë falas dhe në dispozicion publik (neni 10). Katalogu qendror i të dhënave nga institucionet shtetërore, të cilin Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës është e detyruar ta menaxhojë, është në dispozicion në internet në: [www.data.gov.mk](http://www.data.gov.mk). Për fat të keq, për momentin, ka shumë pak sete të të dhënave me të dhëna të ndara sipas gjinisë në këtë regjistër.

Edhe pse nuk janë pjesë e sistemit zyrtar statistikor, shumë institucione dhe agjenci kombëtare mund të japin të dhëna të dobishme për të informuar politikat për barazi gjinore. Për shembull, Agjencia e Kadastrës mund të japë të dhëna për numrin e të drejtave për pronësi të regjistruara për burrat dhe gratë, të cilat do të japin një tregues të pabarazisë gjinore në pronësinë e pasurive të patundshme, të dhëna që statistika zyrtare nuk i prodhon ende.

---

7 Ligji për përdorimin e të dhënave nga sektori publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 27 nga 05.02.2014

## Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme kanë të bëjnë me integrimin e aspekteve gjinore në politikat kryesore të statistikës zyrtare kombëtare dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve kryesorë kombëtarë. Është e rëndësishme të theksohet se institucionet kombëtare, makineria gjinore dhe sistemi zyrtar statistikor duhet të bëjnë përpjekje të koordinuara dhe vullnet politik për të përfshirë perspektivën gjinore në sistemin statistikor dhe për të integruar statistikat gjinore në politikat publike për barazi gjinore.

### Përfshirja e perspektivës gjinore në sistemin statistikor

- Përditësim të Ligjit për Statistikë për të përmendur në mënyrë specifike se të gjitha të dhënat në lidhje me individët duhet të ndahen sipas seksit.
- Sigurimi që Ligji i ri për Barazi Gjinore të përkufizojë dhe njohë statistikën gjinore.
- Formalizimi i përgjegjësisë për futjen e gjinisë në sistemin statistikor përmes një mekanizmi koordinimi ose një njësie kompetente në kuadër të sistemit statistikor.
- Politika zyrtare për barazi gjinore duhet të përkufizojë një strukturë koherente të objektivave të (nën)qëllimeve të politikës, të operacionalizuara përmes treguesve gjinorë, në kuadër të statistikës zyrtare. Treguesit gjinorë duhet të përzgjidhen përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe këshilluese brenda dialogut prodhues - përfitues. Struktura e treguesve të përzgjedhur duhet të përdoret për të ndjekur dhe vlerësuar zbatimin e ndërhyrjeve të politikave dhe për ndjekjen sistematike të ndryshimeve me kalimin e kohës. Përmbledhja e treguesve gjinorë duhet të jetë në dispozicion publik si një bazë e të dhënave e menaxhuar nga EShS.
- EShS-ja duhet të jetë në gjendje të përdorë kompetencat e saj për të parashikuar nevojat për statistika gjinore. Ekspertiza për statistika gjinore mund të rritet përmes shkëmbimit të praktikave dhe trajnimeve ndërkombëtare.
- Futja e drejtimit gjinor në programin e ardhshëm pesëvjeçar statistikor si një akt nënligjor kryesor që përcakton se cilat anketa statistikore do të kryhen. Proceset konsultative duhet të përfshijnë ekspertizën për çështjet gjinore.
- Praktikrat ekzistuese duhet të njohin paragjykimet e mundshme gjinore



gjatë mbledhjes, përpunimit, ruajtjes dhe paraqitjes së të dhënave statistikore. Duhet të ketë diskutime sistemore që statistika zyrtare të pasqyrojë çështjet akute gjinore, interseksionalitetin dhe diversitetin.

- Të dhënat nga regjistrimi i ri duhet të përdoren për të zhvilluar një bazë të dhënash të treguesve gjinorë për komunitat.
- Në kuadër të dialogut prodhues - përfitues, EShS, me palët e tjera të përfshira, duhet të punojë në ngritjen e njohurive statistikore dhe përdorimin e statistikave gjinore. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit në bashkëpunim me EShS duhet të marrin në konsideratë futjen e moduleve të edukimit për statistikë në planprogramet standarde mësimore.
- Statistikat gjinore si koncept duhet të njihen brenda praktikave operative të organeve të tjera të autorizuar për statistikë shtetërore. Organet e autorizuar për statistika shtetërore duhet të kenë regjistrime statistikore të përditësuara në dispozicion publik, të ndara sipas gjinisë. Të gjitha organet e autorizuar duhet të bëjnë përpjekje për publikimin e të dhënave në formate që janë të përshtatura për përpunim të të dhënave.
- Komiteti Koordinues dhe EShS-ja duhet të bashkëpunojnë me organet e autorizuar për të forcuar kapacitetet e tyre për të përvetësuar parimet dhe treguesit e Kodit të Praktikës së Statistikës Evropiane dhe për të siguruar cilësinë e statistikave të prodhuara, përfshirë statistikat gjinore. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale duhet të konsiderohet si një organ potencialisht i autorizuar për të rritur disponueshmërinë e statistikave sociale dhe statistikave gjinore.
- Duhet të sigurohen alokime të mjaftueshme buxhetore për ruajtjen dhe zhvillimin e personelit dhe ekspertizës dhe që EShS-ja të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e saj si organ koordinues në kuadër të sistemit zyrtar statistikor shtetëror.

### **Treguesit gjinorë që janë në dispozicion**

- Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut, si një përmbledhje vjetore e statistikave gjinore të publikuara nga EShS, duhet të përfshijë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të statistikave në dispozicion për pabarazitë gjinore. Përveç fushave ekzistuese, në mënyrë plotësuese ajo duhet të përfshijë të dhëna zyrtare në dispozicion për punën e papaguar dhe pabarazitë në përdorimin e kohës, pushtetit dhe vendimmarrjes, pronësinë dhe dhunën me bazë gjinore. Duhet të bëhen përpjekje për të përfshirë tregues përkatës siç janë hendeku gjinor në paga (i përshtatur dhe i pa përshtatur) dhe hendeku

gjinor në pensione. Botimi duhet të përmbajë, ndër të tjerat, statistika të përmbledhura nga Anketa e përdorimit të kohës, Anketa e të ardhurave dhe kushteve për jetesë, Anketa për strukturën e fitimeve.

- Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar që Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut të përfshijë një rishikim më gjithëpërfshirës të të dhënave nga organet e tjera të autorizuara shtetërore për statistika, siç janë Instituti i Shëndetit Publik, Banka Kombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Punësim dhe Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor.
- Statistika gjinore në botimin Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut duhet të kontekstualizohet me referenca (aty ku dhe kur është e mundur) në kuadrin e politikave për barazi gjinore. Ndryshimet në të dhëna me kalimin e kohës duhet të interpretohen në drejtim të një uljeje ose rritjeje të mundshme të pabarazive gjinore. Aty ku është e përshtatshme, përdoruesit duhet të informohen nëse ndryshimet metodologjike, në hulumtimet përkatëse, mund të kenë pasur implikim tek ndryshimet e vërejtura në të dhënat e serive kohore, në mënyrë që të mos interpretohen si ndryshime faktike në lidhje me pabarazitë gjinore.
- Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut duhet të adresojë pabarazitë interseksionale dhe aty ku të dhënat janë të disponueshme duhet të ndahen sipas variabëlve që shënojnë kategoritë e marginalizuara ashtu siç njihen në politikat publike dhe legjislationin kombëtar.
- Meqenëse siguron qasje fleksibile dhe të synuar në statistikat gjinore, duhet të bëhen përpjekje për të siguruar që dosja e Treguesve Gjinorë në bazën e të dhënave MakStat të jetë e përditësuar dhe e pasuruar me të dhëna nga fusha të ndryshme tematike, nivele territoriale dhe burime. Për të dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme, lista e treguesve duhet të organizohet në fusha tematike ose brenda një kornize të synimeve specifike të politikave publike për barazinë gjinore. Dosja duhet të plotësohet më tej me të dhëna të ndara sipas gjinisë për komunat e përfshira në regjistrimin e vitit 2021.
- Prodhimi i Indeksit Kombëtar për Barazi Gjinore për Maqedoninë e Veriut, i zhvilluar sipas metodologjisë së Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) duhet të institucionalizohet për të ndjekur botimet e ardhshme në nivel të BE-së. Të dhënat për dhunën dhe pabarazitë interseksionale duhet të futen në edicionin e ardhshëm të Indeksit për Barazi Gjinore të Maqedonisë së Veriut.
- Korniza gjithëpërfshirëse konceptuale dhe metodologjike e Indeksit për Barazi Gjinore, e cila është përshtatur për të qenë e integruar me objektivat

e politikave të BE-së për barazinë gjinore dhe mundëson monitorim e krahasueshëm të progresit, mund të jetë një vend i mirë për të filluar të shohim se ku jemi dhe t'i lidhim statistikat gjinore me objektivat kombëtare të politikave për barazi gjinore.

### **Të dhënat administrative të disponueshme nga institucionet kombëtare që mund të përdoren për të informuar politikën për barazi gjinore**

- EShS-ja duhet të shqyrtojë burimet e mundshme të të dhënave administrative për statistikat gjinore dhe duhet të zhvillojë procedura për të siguruar cilësinë e të dhënave administrative për t'i ngritur ato në statistika zyrtare.
- Subjektet publike duhet të respektojnë detyrimet e tyre ligjore për publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Infrastruktura e TI-së për menaxhimin administrativ të të dhënave duhet të përshtatet në mënyrë adekuate ndërsa duhet të bëhen ndarje të mjaftueshme buxhetore dhe profesionale nga organet kompetente.
- Katalogu qendror i të dhënave nga institucionet shtetërore duhet të përditësohet për të përfshirë përmbledhjet e të dhënave të ndara sipas seksit.

### **Barazia gjinore - një vështrim i shkurtër përmes numrave**

Në vijim janë përmbledhur disa nga statistikat kryesore gjinore dhe të dhënat administrative të ndara sipas gjinisë, të mbledhura përmes burimeve të ndryshme, të grupuara sipas gjashtë synimeve kryesore të barazisë gjinore:<sup>8</sup>

- » Shpërndarja e barabartë e fuqisë dhe ndikimit
- » Barazia financiare midis grave dhe burrave
- » Ndarja e barabartë e kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake
- » Arsimi i barabartë
- » Shëndeti i barabartë
- » Dhuna me bazë gjinore duhet të ndalet


---

8 Inspirim janë qëllimet e barazisë gjinore për të cilat angazhohet qeveria suedeze - për më shumë shikoni këtu: <https://www.government.se/49c517/globalassets/government/dokument/socialdepartementet/summary-of-the-government-communication-power-goals-and-agency-a-feminist-policy.pdf>

## Shpërndarja e barabartë e fuqisë dhe ndikimit

Që nga krijimi i shtetit, asnjë grua nuk është zgjedhur presidente, ndërsa vetëm një është emëruar për kryeministre të qeverisë edhe atë vetëm si ushtruese e detyrës së kryeministrit, në kohëzgjatje prej gjithsej 50 ditëve në vitin 2014. Gjithsej, nga viti 2008 deri në vitin 2021 (periudha për të cilën kishim të dhëna të disponueshme), vetëm 12% nga ministrat e emëruar ishin gra, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet dhe rikonstruimet. Në nivel lokal, vetëm 3% e kryetarëve të zgjedhur të komunave ishin gra (të dhëna nga viti 1996 deri në vitin 2022). Gjatë viteve, përfaqësimi ka qenë relativisht më i mirë, por ende larg nga barazia në parlamentin kombëtar dhe këshillat lokalë, por kjo është vetëm për shkak të kuotave të vendosura me ligj për gjininë e nënpërfaqësuar.

### Përfaqësimi politik



Burimi: Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), Baza e të dhënave për statistika gjinore.


## **Barazia financiare midis grave dhe burrave**

Shkalla e punësimit si për burrat ashtu edhe për gratë është rritur në dekadën e fundit, por hendeku gjinor në punësim është vazhdimisht i lartë, duke qëndruar në 19 pikë përqindje në vitin 2020, që është pothuajse dyfishi i mesatares evropiane. Edhe më i madh se hendeku gjinor në punësim është hendeku gjinor në aktivitetin në tregun e punës. Pothuajse gjysma e grave në moshë pune janë jashtë tregut të punës, d.m.th. ato nuk kanë as punësim të paguar dhe as nuk janë të regjistruara si punëkërkuese.

Pabarazitë gjinore janë gjithashtu të dukshme edhe në qasjen deri tek burimet financiare. Për shkak të besimeve tradicionale që përshkruajnë të drejtat e trashëgimisë për pasardhësit meshkuj, gratë kanë dukshëm më pak gjasa të zotërojnë tokë ose pasuri të patundshme. Sipas të dhënave administrative të Agjencisë së Kadastrës, vetëm 27% e të drejtave të regjistruara të pronësisë së tokës u përkasin grave. Kjo pabarazi prek veçanërisht gratë rurale, duke qenë se toka është shpesh burimi më i rëndësishëm në prodhimin bujqësor. Gratë që nuk zotërojnë pronë kanë fuqi më të dobët negociuese në familje dhe kështu janë më të cenueshme ndaj dhunës ekonomike. Kjo mbështetet më tej nga statistikat zyrtare që tregojnë se shumica e punëtorëve të papaguar në familje janë gra.


Pabarazitë në qasjen deri tek burimet mund të vërehen më tej në mundësitë për lëvizje. Për të realizuar të drejtën e tyre për punë, arsim, kohë të lirë ose nevoja të tjera, shumica e grave varen nga transporti publik ose nga (anëtarë të familjes) të tjerë që posedojnë një veturë. Sipas të dhënave administrative nga Ministria e Punëve të Brendshme, vetëm 18% e makinave private janë në pronësi të grave.

### Shkalla e punësimit (popullsia nga 15 deri në 64 vjet)




Burimi: Eurostat, Anketa e fuqisë punëtore.

### Shkalla e aktivitetit (nga 15 deri në 64 vjeç)




Burimi: Eurostat, Anketa e fuqisë punëtore.

### Pronësia e tokës (2019)




Burimi: Agjencia për kadastrë të patundshmërive – Republika e Maqedonisë së Veriut

### Pronësia e veturave (2020)



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (Kërkesa për liri të informimit)

### Mjeti transportues që përdoret më shpesh nga gratë dhe burrat deri tek puna apo shkolla (15+)




Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Regjistrimi i popullsisë, amvisëri dhe banesa, 2021

## **Ndarja e barabartë e kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake**

Nëse analizohet koha që i kushtohet kujdesit për fëmijët, familjen dhe aktivitetet shtëpiake në lidhje me mirëmbajtjen e shtëpisë (p.sh. pastrimi, gatimi, etj.), do të konkludohet se mesatarisht 72% e kohës për këtë punë të papaguar investohet nga gratë, ndërsa burrat marrin pjesë me rreth një të katërtën e kohës së kaluar për punë të papaguar për kujdes.

Shpërndarja e pabarabartë e punës së kujdesit të papaguar është një nga arsyt kryesore për qasje të pabarabartë deri tek punësimi me pagesë, pra për shkallët e larta të pasivitetit ekonomik tek gratë. Më shumë se gjysma (55%) e grave në moshë pune nuk janë as të punësuar dhe as të regjistruara si punëkërkuese aktive.<sup>9</sup> Për më shumë se gjysmën e grave që nuk janë aktive në tregun e punës, arsyeja kryesore pse janë jashtë tregut janë obligimet që lidhen me kujdesin për fëmijët dhe personat e tjerë, si dhe arsye të tjera familjare. Në vitin 2020, kjo është arsyeja kryesore për 59% të grave që nuk janë aktive në tregun e punës krahasuar me 2% të burrave. Ky “numër” përfshin kategorinë e amviseve/ëve, e cila në statistikat zyrtare ndër vite është 100% e mbushur nga gratë.

### **Pjesëmarrja e grave dhe burrave në punën e përgjithshme të kujdesit të papaguar, 2014/2015**




Burimi: Charmes, J. (2019). The Unpaid Care Work and the Labour Market. Analiza e të dhënave për përdorimin e kohës, bazuar në përpilimin më të fundit botëror të anketave për përdorim të kohës. Zyra Ndërkombëtare e Punës – Gjenevë: ILO, 2019. Gjetet në: [https://bit.ly/3824AoA\\_](https://bit.ly/3824AoA_). Kalkulimet e autorit bazohen në të dhënat e Entit Shtetëror për Statistikë (2015). Anketa e përdorimit të kohës, 2014/2015.

9 Baza e të dhënave MakStat. Shkalla e aktivitetit të popullsisë së moshës 15 vjeç e lart sipas gjinisë dhe moshës, sipas vitit, 2021. Gjetet në: [https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_\\_PazarNaTrud\\_\\_StapkiDrugIndikator/006\\_PazTrud\\_Mk\\_aktivnost\\_mk.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__PazarNaTrud__StapkiDrugIndikator/006_PazTrud_Mk_aktivnost_mk.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)



## Popullsia joaktive për shkak të obligimeve për kujdes (të moshës nga 20 deri në 64 vjet)




Burimi: Eurostat, Anketa e fuqisë punëtore.

## Arsimi i barabartë

Arsimi është një nga fushat e rralla në të cilat pabarazitë gjinore tregojnë se gratë janë në një pozitë më të mirë edhe pse dallimet nuk janë të mëdha. Për shembull, 22% e grave të moshës 15-64 vjeç kanë një arsim të lartë krahasuar me 18% të burrave.


Arsimi është një burim i rëndësishëm në tregun e punës dhe ajo që mund të jetë shqetësuese janë statistikatat që tregojnë se vendi ynë ka një nga shkallët më të larta të të rinjve që nuk janë as të punësuar dhe as në arsim, krahasuar me vendet e tjera të Evropës.

## Shkalla e arsimit të lartë (15-64 vjet)



Burimi: Eurostat, Anketa e fuqisë punëtore.


## Të rinjtë që nuk janë as të punësuar, as në proces arsimor ose trajnim



Burimi: Eurostat, Anketa e fuqisë punëtore.

## Shëndet i barabartë

Sipas statistikave zyrtare, gratë kanë jetëgjatësi më të madhe se burrat. Në vitin 2019, jetëgjatësia mesatare për gratë është 79 vjeç, ndërsa për burrat është 75 vjeç.



Burimi: Eurostat, Popullsia dhe kushtet sociale.


## **Dhuna me bazë gjinore duhet të ndalet**

Enti Shtetëror i Statistikave ende nuk e ka kryer Anketën për Dhunën me bazë gjinore, e cila do të ofrojë njohuri për prezencën e dhunës me bazë gjinore.

Sipas një kërkimi të OSBE-së të bërë në vitin 2018 në një mostër kombëtare, më shumë se gjysma ose 54% e grave në Maqedoninë e Veriut kanë përjetuar një formë të dhunës gjatë jetës së tyre. Pothuajse një në tre gra ka qenë e ngacmuar seksualisht (30%), 14% kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale dhe çdo e dhjeta ka përjetuar përndjekje (7%). Dhuna psikologjike nga një partner intim përjetohet më shpesh, ndërsa 44% e grave kanë pësuar këtë lloj dhune<sup>10</sup>.

Ministria e Punëve të Brendshme, ndër të tjerat, ka të dhëna për numrin e burrave dhe grave që kanë qenë viktime të krimeve të kryera në rrethana të rënduara të dhunës familjare. Megjithëse nuk mund të përmbillet nga këto numra se sa shpesh ndodh dhuna në familje (sepse në shumicën e rasteve, për fat të keq, mbetet e pa raportuar), megjithatë janë indikativ dallimet që tregojnë dimensionin gjinor, d.m.th. fakti që shumë më shumë gra janë të ekspozuara ndaj dhunës në familje.


### **Vepra penale të kryera në rrethana të rënduara të dhunës në familje.**



10 Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë (OSBE) (2019). Mirëqenia dhe Siguria e Grave - Një hulumtim i zbatuar nga OSBE mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut. [https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/424409\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/424409_0.pdf)

Të dhëna të bazuara në kërkesat për liri të informimit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Veprat penale që lidhen me dhunën në familje përfshijnë vrasje, tentim për vrasje, lëndime trupore, lëndime të rënda trupore, kërcënime për sigurinë, etj. Nga ana tjetër, njohja e dimensionit gjinor të dhunës nënkupton gjithashtu depërtim në statistikën që tregon se shumë burra vuajnë nga dhuna e burrave të tjerë, por edhe se burrat janë më shpesh viktimat e vetëvrasjes.

### Të vdekur nga një vdekje e dhunshme



Burimi: Enti Shtetëror për Statistikë

